

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6430  
E hënë, 4 tetor 2021  
çmimi 0.40

## Rama paralajmëron krizë të jashtëzakonshme energjetike



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# SOT FILLON RECIPROCITETI PËR TARGAT

FAQE 4-5



Pas përmbushjes së pikës së parë të marrëveshjes së Brukselit për targa në mes të Kosovës dhe Serbisë, sot (e hënë) fillon zbatimi i reciprocitetit në targa ndërmjet dy shteteve ashtu siç është paraparë në pikën e dytë të kësaj marrëveshjeje. Deri në gjetjen e një zgjidhje të përhershme, në vend të heqjes së

targave të automjeteve të regjistruara në Kosovë dhe Serbi, mbi simbolet shtetërore të targave do të vendoset letër ngjitëse. Ndërsa Policia e Kosovës ka bërë me dije se pas largimit të barrikadave rrugët në drejtim të pikave kufitare Jarinjë dhe Bërnjak i janë kthyer normalitetit

## BËHET THIRRJE PËR FUSHATË MË CILËSORE DHE DISKUTIME PËR PROGRAME

FAQE 3



## SHBA-ja DHE FRANCA DO TË ZHVILLOJNË BISEDIME PËR ZGJIDHJEN E NDASIVE

FAQE 2

## AKTUALE



### DY VIKTIMA DHE 23 RASTE TË REJA ME COVID-19 NË KOSOVË

F.3

### MUNGESË E INSPEKTORËVE SANITARË NË DISA KOMUNA TË KOSOVËS

F.6

### URAN ISMAILI NËNSHKRUAN ZOTIMET PËR COLLAKUN: DO TË KRYHEN PËR DY VJET

F.6

## EKONOMI



### KUVENDI DERI NË FUND TË VITIT PRITET TA MIRATOJË LIGJIN PËR KRIPTOVALUTA

F.7

### MINISTRI MURATI PUBLIKON BORXHET E 10 KOMUNAVE, PRIN GJILANI ME 10.45 MILIONË EURO

F.7

## SPORT



### DRITA NDAN PIKËT ME PRISHTINËN, FITOJNË LLAPI DHE FERONIKELI

F.12

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhep isht  
Tetov\*  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 000  
+389 44 487 795  
Fax: +389 44 487 300  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
ND, RTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOV.  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin, Kosov\*,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# ShBA-ja dhe Franca do të zhvillojnë bisedime për zgjidhjen e ndasive

WASHINGTON, 3 TETOR - Shtetet e Bashkuara dhe Franca do të zhvillojnë bisedime më 5 tetor në përpjekje për t'i ulur tensionet diplomatike.

Marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve u përkeqësuan muajin e kaluar pasi Australia anuloi një marrëveshje të mëparshme për blerjen e nëndetëseve franceze prej miliarda dollarësh. Anulimi u bë pasi Australia nënshkroi marrëveshje në fushën e mbrojtjes me ShBA-në dhe Britaninë e Madhe, sipas së cilës,



ky vend do të furnizohej me nëndetëse përmes teknologjisë amerikane dhe britanike.

Ministri i Punëve të Jashtme i Francës, Jean-Yves Le Drian, do të zhvillojë bisedime në Paris me

sekretarin e Shtetit, Antony Blinken. "Të dy ministrat do të zhvillojnë bisedime me qëllim të identifikimit të hapave që do të nevojiten për ta rivendosur besimin midis dy vendeve tona. Siç kishte thënë ministri (Jean-Yves Le Drian) në Nju-Jork, dalja nga kjo krizë do të marrë kohë dhe do të ketë nevojë për veprime të fuqishme", ka thënë zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Franceze, Anne-Tha Claire Legendre.

Presidenti amerikan Joe Biden dhe presidenti i Francës

Emmanuel Macron kanë biseduar për raportet mes dy vendeve dhe kanë premtuar se do të vazhdojnë "konsultimet".

Blinken viziton Parisin nga e hëna deri të mërkurën dhe do të kryesojë një takim të ministrave nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD).s

Në delegacion me sekretarin Blinken janë edhe i dërguari amerikan për çështjen e klimës, John Kerry, përfaqësuesja e Tregtisë e ShBA-së, Katherine Tai dhe zyrtarë të tjerë amerikanë.

## Trumpi i drejtohet gjykatës për llogarinë në "Twitter"

WASHINGTON, 3 TETOR - Ish-presidenti amerikan Donald Trump ka kërkuar nga një gjykatës federal që ta urdhërojë kompaninë "Twitter" t'ia aktivizojë llogarinë e tij në këtë rrjet social.

"Twitter" e kishte bllokuar llogarinë e Trumpit për shkak të trazirave në muajin janar në Kongresin amerikan.

Ndalimi i përhershëm i Trumpit nga "Twitter" pati nxitur debat nga mbështetësit, por edhe kundërshtarët e kësaj mase, të cilët thoshin se një vendim i tillë shpërfaq fuqinë e kompanive të

teknologjisë amerikane në debatin publik të vendit.

Në kërkesën e tyre të paraqitur në Gjykatën Federale amerikane në Florida, avokatët e Trumpit thanë se vendimi i "Twitter"-it ishte i "detyruar" nga ligjvënësit e Kongresit. "Twitter"-i ushtron një shkallë të fuqisë dhe kontrollit mbi debatin politik në këtë vend", thanë avokatët e Trumpit në dosje.

Atëbotë vendimi i "Twitter"-it u pasua edhe nga kompani të tjera të teknologjisë.

Më 6 janar, përkrahësit e Trumpit u përleshën me policinë dhe më

pas hynë në ndërtesën e Kongresit amerikan, duke dëmtuar pjesë të tij dhe duke kërcënuar ligjvënësit.

Sulmi erdhi derisa Kongresi po mbante takim për të vërtetuar fitoren e Joe Bidenit në zgjedhjet presidenciale që ishin mbajtur dy muaj më parë.

Disa orë para sulmit, Trump iu drejtua një turme të madhe të përkrahësve të tij duke iu bërë thirrje që të "luftojnë si në ferr". Ai nuk bëri thirrje në mënyrë eksplicite për ta sulmuar Kongresin.

Trump më vonë u akuzua nga



Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, për nxitje të dhunës. Senati i kontrolluar nga republikanët e

shpalli të pafajshëm. Para se t'i bllokohej llogaria, Trump kishte më shumë se 88 milionë ndjekës në "Twitter".

## Izraeli rrit presionin për dozën e tretë të vaksinës

JERUSALEM, 3 TETOR - Qeveria e Izraelit po rrit presionin ndaj personave që janë vaksinuar me dy dozat e vaksinës kundër koronavirusit. Nga dita e diel certifikata e vaksinimit e cila lehtëson lëvizjen dhe qasjen në jetën publike do të jetë e vlefshme vetëm gjashtë muaj pas marrjes së dozës së dytë të vaksinës.

Pas kësaj periudhe njerëzit duhet të marrin dozën e tretë përforcuese për të pasur mundësi të hyjnë në ambiente të mbyllura. Izraeli është vendi i parë që e përfshiu dozën



përforcuese të vaksinës në certifikatën e vaksinimit. Masa po shihet gjerësisht si një hap për ta inkurajuar vaksinimin me dozë përforcuese.

Sipas shifrave të Ministrisë së Shëndetësisë, më shumë se 1 milion njerëz mund të preken nga rregullorja e re. Certifikata është e nevojshme për

të marrë pjesë në pothuajse të gjitha fushat e jetës publike në Izrael. Nga moshë tre vjeç e tutje duhet të dëshmojnë se janë vaksinuar, janë shëruar nga Covid-19 ose janë testuar negativ nëse duan të vizitojnë ngjarje sportive ose kulturore, palestra, muze, restorante, universitete ose konferenca.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, rreth 61 për qind e afërsisht 9.4 milionë banorëve janë vaksinuar me dy doza, ndërsa rreth 37 për qind me dozë përforcuese.

Parakushti për dozën e tretë është që vaksinimi i dytë të jetë bërë së paku pesë muaj më parë.

Në fillim të shtatorit Izraeli regjistroi më shumë se 11 000 infeksione të reja në ditë, numri më i lartë që nga fillimi i pandemisë. Që nga atëherë numri ka rënë gradualisht.

Shumë izraelitë organizuan demonstrata në të gjithë vendin në shenjë proteste ndaj masave të reja. Kundërshtarët thanë se kjo është një formë e vaksinimit të detyruar.

## Miliarderi rus kërkon azil në Mal të Zi

MOSKË, 3 TETOR - Një miliarderi rus me origjinë nga Azerbajxhani është arrestuar në Mal të Zi pasi Rusia e kërkonte atë nën dyshimet se ka urdhëruar vrasje me pagesë.

Mediat lokale në Mal të Zi raportuan më 2 tetor se Telman Ismailov ka paraqitur kërkesën për azil në këtë vend, një ditë pasi u arrestua në Podgoricë, pasi ndaj tij kishte një urdhërarrest ndërkombëtar

të lëshuar nga Rusia. Gazeta Vijesti raportoi se kërkesa për azil politik mund ta komplikojë ekstradimin e Ismailovit në Rusi. Djali i tij, Alekper Ismailov, ka në pronësi një kazino në qytetin bregdetar

të Budvës. Në Rusi, miliarderi rus, akuzohet se më 2016 ka paguar për vrasjen e dy biznesmenëve në rajonin e Moskës. Ai akuzohet, gjithashtu, për rrëmbimin e një këngëtarit në vitin 2004.



# Bëhet thirrje për fushatë më cilësore dhe diskutime për programe

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 TETOR - Misioni vendor për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" në një konferencë për media ka shpalosur të gjeturat kryesore nga vëzhgimi i gjysmës së parë të fushatës për zgjedhjet lokale të 17 tetorit.

Eugen Cakolli nga DnV-ja ka theksuar se vëzhgimi i kësaj periudhe është bërë duke u fokusuar në pesë elemente kyçe, përfshirë respektimin e masave anti-Covid dhe rregullave zgjedhore, formatin e fushatës, ofertat politike, kandidaturat, duke përfshirë aty edhe aspektin gjinor, si dhe shpenzimet e kandidatëve të subjekteve politike. Sipas DnV-së, përvoja e krijuar nga dy palë zgjedhje paraprake në Kosovë në kohë pandemie ua ka dhënë kohën e nevojshme subjekteve politike që t'i adaptojnë strategjitë e tyre për rrethanat e reja, duke e orientuar fushatën e tyre kryesisht në platforma digjitale. "Gjithsesi nuk kanë munguar edhe aktivitetet zgjedhore me prani fizike të qytetarëve, ku po vërehet një dozë më e lartë përgjegjësie për respektimin e masave kundër Covid-19 për dallim nga zgjedhjet e fundit parlamentare të shkurtit 2021. Sidoqoftë, respektimi i distancës sociale dhe vendosja e maskës gjatë këtyre aktivitetëve lë shumë për të dëshiruar, sidomos në hapësirat e mbyllura që subjektet dhe kandidatët po mbajnë në zonat rurale", ka thënë Cakolli. Ndryshe nga fushatat e kaluara zgjedhore, kësaj here shpalosja e programeve politike është bërë që në fillim të fushatës, element të cilin kandidatët duket se e kanë vlerësuar si përparësi konkurruese në garë.

Cakolli ka theksuar se debutimi i kandidatëve me oferta më të qarta programore është duke e ndryshuar për të mirë edhe diskursin dhe gjuhën e fushatës krahasuar me diskutimet e dikurshme, që përbërës kryesorë kishin akuzat e kundërakuzat. Ai ka shtuar se rrjetet sociale, e



sidomos platformat "Facebook" dhe "Instagram", së bashku me debatet televizive, janë dy kanalet më të përdorura për publikimin e platformave politike. "Megjithatë, shpenzimet e bëra nga kandidatët për sponsorizime në rrjetet sociale nuk janë bërë publike, ndonëse është e evidente që numri i artikujve të sponsorizuar është rritur ndjeshëm gjatë kësaj fushate", ka deklaruar Cakolli.

Sa i përket përmbajtjes, investimet kapitale janë kryefjala e programeve të shumicës së kandidatëve. "Po ashtu, është vërejtur një kalim nga ofrimi i premtimeve që në esencë janë të karakterit mirëmbajtës të gjendjes aktuale te projektet transformuese. Një vlerë e shtuar e programeve të një pjese të konsiderueshme të kandidatëve janë edhe politikat ambientaliste të cilat kanë gjetur hapësirë dukshëm më të madhe në këtë fushatë", ka thënë ai.

Edhe pse shumica dërrmuese e premtimeve të kandidatëve janë brenda fushëveprimit dhe kompetencave që kanë komunat, edhe në këto zgjedhje nuk kanë munguar rastet kur kandidatë të caktuar kanë dhënë premtime apo kanë përfshirë në programet e tyre çështje që janë kompetencë e nivelit qendror.

Cakolli ka thënë se fushata e

deritanishme është karakterizuar me një gjuhë përgjithësisht të relaksuar mes kandidatëve si dhe pa ndonjë rast serioz të përdorimit të gjuhës së urrejtjes mes kandidatëve. "I vetmi rast atipik në këtë drejtim është organizimi i një lloj proteste nga ana e përkrahësve të një subjekti politik (LV) kundër kandidatit nga radhët e një subjekti tjetër (PDK)", ka thënë ai.

Lidhur me kandidaturat, DnV-ja

vlerëson që, sikur edhe në proceset e kaluara zgjedhore, është vërejtur një koncentrim dukshëm më i madh i aktivitetëve të fushatës për promovimin e kandidatëve për kryetarë komunash, duke lënë në hije kandidatët për kuvendet komunale. "Kandidatët për kuvende komunale janë parë më shumë si 'dekor' gjatë aktivitetëve apo takimeve të subjekteve politike. Gjithsesi, vlen të theksohet se është shënuar

avancim sa i përket hapësirës mediale që u është ofruar kandidatëve për kuvendet komunale me të cilët janë organizuar disa debate televizive. Përkundër thirrjeve të vazhdueshme për përfshirje të më shumë grave në lista zgjedhore, subjektet politike përgjithësisht kanë vijuar respektimin e kriterit minimal ligjor prej 30-përqindësh vetëm në kuadër të listave për kuvendet komunale", është shprehur Cakolli.

Ai ka treguar se në radhët e kandidatëve për kryetarë komunash më shumë se gjysma e tyre (rreth 55 për qind) janë kandidatë që nuk kanë garuar më parë. "Kjo është e shprehur sidomos në kryeqytet, ku gjashtë nga shtatë kandidatët garojnë për herë të parë. Po ashtu, karakteristikë e kandidaturave është edhe garimi i kandidatëve për kryetarë, njëkohësisht edhe si bartës të listave për kuvendet komunale. Rreth një e treta e kandidatëve për kryetarë komunash, përkatësisht 50 sosh, janë edhe bartës të listave për kuvendet komunale. Ndërsa si bartës të listave për kuvendet komunale kemi edhe pesë deputetë të Kuvendit, tre prej të cilëve janë edhe kandidatë për kryetar komune", ka deklaruar ai.

## Dymbëdhjetë deputetë dhe një ministër në garën për të parin e komunës

Kandidimi në zgjedhjet lokale i zyrtarëve që veçse janë zgjedhur apo emëruar në një pozitë tjetër të lartë publike ka qenë fenomen i shprehur edhe në këto zgjedhje. "Ndër ta, kemi të paktën 12 deputetë dhe një ministër të cilët i janë futur garës për të parin e komunës. Ndërsa ka edhe deputetë që garojnë edhe vetëm për kuvendin komunal. Duke pasur parasysh angazhimin e madh që kërkohet si në ushtrimin e pozitës publike ashtu edhe në garën zgjedhore, kandidimi në këto të fundit është parimorë që të pasohet nga dorëheqja nga pozita publike, edhe pse

kjo nuk përbën obligim ligjor. Dy rastet e dorëheqjes, fillimisht nga deputeti Uran Ismaili, së fundi në mes të fushatës edhe nga tashmë ish-ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, të cilët garojnë për kryetar të Prishtinës, është dashur të ndiqen edhe nga kandidatët e tjerë", ka thënë Cakolli.

Bazuar në këto të gjetura, DnV rekomandon që edhe në pjesën e mbetur të fushatës dinamizimi i saj të mos komprometojë nivelin e zbatimit të masave anti-Covid. "Në këtë drejtim institucionet përkatëse të inspektimit, si të nivelit qendror ashtu edhe të

atij lokal, duhet të kryejnë inspektime më të shpeshta në aktivitetet e fushatës për të garantuar respektimin e masave si mbajtja e maskës, distanca fizike, si dhe kontrolli për certifikatën e vaksinimit apo testin negativ", është shprehur ai.

DnV, gjithashtu, kërkon të ketë përfshirje edhe më të madhe të kandidatëve gra në fushatë, sidomos në paraqitje mediale dhe debate. Sa iu përket shpenzimeve të kandidatëve, kërkohet nivel më i lartë i transparencës, veçanërisht për shpenzimet e bëra në kuadër të fushatës digjitale dhe në rrjetet sociale.

## Dy viktima dhe 23 raste të reja me Covid-19 në Kosovë

PRISHTINË, 3 TETOR - Kosova vazhdon të shënojë çdo ditë viktima nga Covid-19 pavarësisht një sërë masash të ndërmarra nga autoritetet për ta parandaluar përhapjen e virusit. Të dielën janë regjistruar dy viktima të reja, ka njoftuar

Ministria e Shëndetësisë. Viktimat janë nga Lipjani dhe Gjilani.

Që nga marsi i vitit 2020 dhe deri më 3 tetor zyrtarët llogaritin se kanë vdekur 2 961 persona.

Bazuar në 2 967 mostra të testuara gjatë 24 orëve të fundit,

23 persona janë konfirmuar pozitivë me koronavirus. Nga sëmundja janë shëruar edhe 114 pacientë. Raste aktive aktualisht janë 2 237. Sipas njoftimit, deri më 3 tetor 565 799 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë të vaksinës kundër Covid-19.





# Sot fillon reciprociteti për targat

Pas përmbushjes së pikës së parë të marrëveshjes së Brukselit për targat në mes të Kosovës dhe Serbisë, sot (e hënë) fillon zbatimi i reciprocitetit në targa ndërmjet dy shteteve ashtu siç është paraparë në pikën e dytë të kësaj marrëveshjeje. Deri në gjetjen e një zgjidhje të përhershme, në vend të heqjes së targave të automjeteve të regjistruara në Kosovë dhe Serbi, mbi simbolet shtetërore të targave do të vendoset letër ngjitëse. Ndërsa Policia e Kosovës ka bërë me dije se pas largimit të barrikadave rrugët në drejtim të pikave kufitare Jarinjë dhe Bërnjak i janë kthyer normalitetit

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 3 TETOR** - Nga sot (e hënë) do të fillojë të zbatohet reciprociteti në targa ndërmjet Kosovës dhe Serbisë sipas marrëveshjes së re të arritur në Bruksel. Pas përmbushjes së pikës së parë për shtensionimin e situatës në veri, pika e dytë e marrëveshjes thotë se nga 4 tetori do të nisë së zbatuari përkohësisht regjimi i letrave ngjitëse, ku do të mbulohe simbolet shtetërore në targat e automjeteve.

Kurse më 21 tetor do të nisë punën një ekip i përbërë edhe nga zyrtarë të Bashkimit Evropian për të gjetur një zgjidhje të përhershme. “Nga 4 tetori do të nisë së zbatuari përkohësisht regjimi i letrave ngjitëse në vend të heqjes së targave të automjeteve të regjistruara në Kosovë dhe Serbi deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme. Më 21 tetor do të nisë punën një ekip i përbërë nga zyrtarë të Bashkimit Evropian, Prishtinës dhe Beogradit për të gjetur një zgjidhje të përhershme. Brenda gjashtë muajve, prej nisjes së takimit të parë, i ashtuquajtur grup punues do t’i prezantojë

gjetjet për një zgjidhje të përhershme në formatin e dialogut të nivelit të lartë”, është thënë në marrëveshjen e 30 shtatorit, e cila është arritur pas dy ditë bisedimesh në Bruksel në mes të zyrtarëve të Kosovës dhe të Serbisë.

Ndërsa të shtunën ka filluar të hyjë në zbatim kjo marrëveshje duke u larguar nga pikat kufitare në veri barrikadat që ishin të vendosura për 13 ditë nga protestuesit serbë dhe Njësitë Speciale të Policisë së Kosovës.

## Kthehet normaliteti në veri

Policia e Kosovës ka bërë me dije se situata në veri është qetësuar. Përmes një njoftimi për media, policia ka treguar se rrugët në drejtim të pikave kufitare Jarinjë dhe Bërnjak janë liruar për qarkullim dhe se gjendja i është kthyer normalitetit. “Gjendja e sigurisë në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, pas largimit të pengesave, lirimit të rrugëve për qarkullim dhe lëvizjes së lirë, i është kthyer normalitetit përderisa njësitet policore patrulluese, përfshirë ato kufitare, vazhdojnë realizimin e detyrave

dhe përgjegjësit ligjore”, është thënë në njoftimin e policisë.

Të shtunën janë zhbllokuar dy pikat kufitare, Jarinjë dhe Bërnjak, të cilat lidhin Kosovën dhe Serbinë. Pjesëtarët e KFOR-it e kanë marrë kontrollin në këto dy lokacione ashtu siç është paraparë në marrëveshje. Këto dy pika kufitare janë bllokuar nga serbët lokalë prej 20 shtatorit, kur Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që ta zbatojë masën e reciprocitetit në targat e automjeteve të regjistruara në Serbi. Por, delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, kanë arritur pajtueshmëri më 30 shtator për çështjen e targave dhe zhbllokimin e veriut.

Në një komunikatë për media, KFOR-i ka thënë se nga kjo fundjavë e deri në dy javët e ardhshme ky mision do të jetë në këtë zonë në përputhje me mandatin që ka.

Palët janë shprehur të kënaqura me marrëveshjen.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se tani fillon epoka kur Serbia nis e mësohet me reciprocitet, ndërkaq presidenti i

Serbisë, Aleksandër Vuçiq, po atë ditë ka thënë se për shtetin e tij “është e rëndësishme” që njësitë speciale të Policisë së Kosovës të tërhiqen nga veriu.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë mirëpritur arritjen e marrëveshjes. Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Gabriel Escobar, i cili është i dërguar i Departamentit të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, ka thënë se Kosova ka pasur të drejtë të vendosë reciprocitetin,

por Uashingtoni është befasuar me mënyrën e zbatimit të këtij vendimi. “Kosova ka të drejtë në reciprocitet dhe kjo ka qenë e ditur, por u zëmë shumë në befasi me mënyrën e zbatimit. Por, këtë e prisnim që të ndodhte në një moment. Jemi të lumtur që siguroam uljen e tensioneve”, ka deklaruar ai.

Ndërsa opozita ka kundërshtuar pikën e parë të marrëveshjes. Sipas saj, në këtë marrëveshje qeveria ka barazuar Policinë e Kosovës me barrikaduesit kriminalë.

## Tahiri: Qeveria i ktheu dy pikat kufitare me Serbinë në protektorat ndërkombëtar

Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për marrëveshjen e fundit në Bruksel. Në profilin e saj në “Facebook”, ajo ka shkruar se me këtë marrëveshje qeveria ktheu në protektorat dy pikat kufitare me Serbinë. “Policia Speciale e Kosovës tërhiqet nga dy pikat kufitare në veri dhe vendosen pjesëtarët e KFOR-it sipas marrëveshjes së fundit në Bruksel, ashtu siç kërkoi Serbia. Kjo do të thotë se kjo qeveri aktuale i ktheu dy pikat kufitare nga pavarësia në protektorat ndërkombë-

tar. Nëse kjo qeveri vazhdon të jetë e paaftë në negociatat e Brukselit, ka rrezik që ta kthejë krejt pjesën veriore në protektorat, që është një synim djallëzor i Serbisë. Po jua kujtoj se në vitin 2011 unë si kryenegociatore me qeverinë e asaj kohe vendosëm kufirin ndërshtetëror në mes të Kosovës dhe Serbisë me marrëveshjen e Brukselit për IBM-in, kthym policinë dhe doganat shtetërore të Kosovës në këto dy pika kufitare. Ndërsa sot shihni ku jemi, fatkeqësisht, duke rrëshqitur mbrapa në protektorat”, ka shkruar Tahiri.

# Kurti: Policët në veri, pavarësisht prej provokimeve, dëshmuan sjellje dhe përkushtim për mbrojtje të sovranitetit

PRISHTINË, 3 TETOR - Pas realizimit me sukses të planifikimeve operacionale dhe zbatimit të vendimeve të institucioneve të Kosovës, në veçanti për angazhimet në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, kanë pritur të dielën në takim stafin e lartë menaxhues të

Policisë së Kosovës, në krye me drejtorin e përgjithshëm, Samedin Mehmeti. Sipas një njoftimi të qeverisë, Kurti i falënderoi dhe u shprehu mirënjohje të gjithë punonjësve të Policisë së Kosovës, të cilët, sipas tij, "me angazhimet e tyre për 13 ditë me radhë, treguan sjellje profesionale, përkushtim të pashoq për mbrojtjen e vendkalimeve dhe policëve kufitarë që po zbatojnë

reciprocitetin e targave të automjeteve, si dhe dëshmuan se Policia e Kosovës është e ndërtuar sipas standardeve evropiane në shërbim të vendit dhe qytetarëve të saj".

"Me këtë vetëmohim e qëndrim profesional në çdo veprim të çdo punonjësi të Policisë së Kosovës u vërtetua se ndër objektivat kyçe të Policisë së Kosovës mbetet zbatimi i ligjit, ruajtja e rendit e

qetësisë publike dhe lëvizja së lirë, duke garantuar kufij të hapur, mirë të kontrolluar dhe të sigurt", ka deklaruar Kurti. Ai e vlerësoi lart punën, angazhimin dhe përkushtimin maksimal, sidomos të Njësisë Speciale të Kosovës, e cila me sjelljen e dinjitetshme, pavarësisht prej provokimeve të llojllojshme, dëshmoi se është profesionale dhe e gatshme ta mbrojë

sovranitetin e shtetit dhe të ofrojë rend dhe siguri anembanë vendit, pa dallim.

Në takim ishin të pranishëm zëvendësdrejtori i përgjithshëm për operativë, Fehmi Hoti, drejtori i Departamentit për Operacione, Gazmend Hoxha, u. d. drejtori i Departamentit për Kufi, Ragip Bunjaku dhe zyrtarë të njësiteve speciale të Policisë së Kosovës.



## Rama paralajmëron krizë të jashtëzakonshme energjetike

TRANË, 3 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, të dielën ka njoftuar se kriza e jashtëzakonshme energjetike do të përfshijë edhe Shqipërinë. "Krizja e jashtëzakonshme energjetike po vjen", ka thënë ai. Sipas Ramës, kjo krizë ka nisur të japë shenja nga Kina dhe Koreja e Jugut, në Amerikë, në Britaninë e Madhe dhe në hapësirën e Bashkimit Evropian e deri në vendet fqinje, si Italia e Greqia. "Temperatura e kësaj krize po rritet kudo, tanimë me orë, jo me ditë, ndërkohë që ulja e temperaturave të motit po afrohet bashkë me dimrin dhe me rritjen e natyrshme të nevojës edhe për ngrohje", ka deklaruar Rama. Sipas Ramës, kjo do të sjellë rritje "marramendëse" të çmimeve të gazit dhe karbonit dhe të

çmimeve të naftës. "Dukuria e rritjes marramendëse të çmimit të gazit e të karbonit në të gjitha tregjet ndërkombëtare, si dhe trendi i fortë i rritjes së çmimit të naftës, shoqëruar me një rritje të përgjithshme çmimesh të prodhimeve të konsumit të përditshëm, qëndrojnë sot para të gjitha vendeve", vijoi Rama. Ai ka shpjeguar se energjia është "trefishuar" në Shqipëri. Krahasuar me vitin e kaluar, "ritmet e larta të rimëkëmbjes" nga pandemia dhe "nevoja e tejrritur" për energji e kanë rritur çmimin e gazit. "Krizja e jashtëzakonshme energjetike, një fatkeqësi e re natyrore e kombinuar me faktorë gjeopolitikë dhe manovra tregtare, një tjetër sfidë e rëndë që nuk e kemi zgjedhur vetë, por të cilën do ta përballojmë me vendosmëri, besim, durim dhe sukses", ka thënë Rama.



## Uran Ismaili nënshkruan zotimet për Gollakun: Do të kryhen për dy vjet

PRISHTINË, 3 TETOR - Kandidati për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka vazhduar nënshkrimin e zotimeve të tij konkrete nëpër lagjet dhe fshatrat e Prishtinës. Të dielën, në Koliq, ai ka nënshkruar punët që do t'i kryejë në dy

vjetët e para të qeverisjes për tërë Gollakun. Ismaili ka thënë se disa prej problemeve të fshatrave të Gollakut i kanë identifikuar, prandaj edhe sot i kanë paraqitur zgjidhjet për problemet më të rëndësishme të kësaj zone

tejet të rëndësishme për Prishtinën. “Të gjitha problemet e përditshme të cilat ua bëjnë jetën e vështirë kanë zgjidhje dhe ato zgjidhje mund të bëhen brenda dy vjetëve të para të mandatit tim si kryetar i Prishtinës”, ka thënë Ismaili.



## Mungesë e inspektorëve sanitare në disa komuna të Kosovës

PRISHTINË, 3 TETOR - Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë për një javë (24 deri 30 shtator) në Kosovë ka zhvilluar 3 528 inspekte për moszbatim të masave të reja kundër koronavirusit, të vëna nga Qeveria e Kosovës.

Zyrtarë të kësaj agjencie kanë thënë se nga këto inspekte, 24 gjoba janë shqiptuar për persona fizikë dhe 39 gjoba për personat juridikë. Kjo agjenci në fokus ka mbikëqyrjen e masave, siç është orari i punës i lokaleve të gastronomisë, mbajtja e ahengjeve, grumbullimi i njerëzve, distanca e tavolinave e të tjera.

Në Kosovë, të hënën, më 27 shtator, kanë hyrë në fuqi masat e reja për luftimin e pandemisë së koronavirusit. Këto masa në të shumtën e rasteve përfshijnë kërkesa për dëshminë e vaksinimit kundër këtij virusi. Në lokale të gastronomisë dhe në qendrat tregtare, në hapësirat e mbyllura, nuk mund të hyhet pa certifikatën e vaksinimit ose testet negative për Covid-19. Këto lokale mund të shfrytëzojnë



50 për qind të hapësirës së mbyllur, ndërsa 70 për qind të hapësirës së hapur.

“Radio Evropa e Lirë” ka vizituar disa lokale në Prishtinë, mirëpo në shumicën e tyre nuk ka pasur punëtorë që kontrollojnë klientët para se të hyjnë brenda nëse janë të vaksinuar apo jo. Sipas Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës, organet kompetente

për shqiptimin e masave ndëshkimore janë Policia e Kosovës, inspektorët shëndetësorë, farmaceutikë, sanitare dhe inspektorët komunalë.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është organi kompetent për monitorimin e zbatimit të masave në sektorin e gastronomisë. Lamir Thaçi, zëdhënës në këtë agjenci, ka thënë se janë duke monitoruar zbatimin e masave në të gjitha

komunat e Kosovës pasi, sipas tij, tashmë ka numër të mjaftueshëm të inspektorëve. Për moszbatimin e masave personi juridik që organizon aktivitet të ndaluar dënohet me gjobë prej 500 deri në 2 000 mijë euro.

Ndryshe qëndron situata në disa komuna të Kosovës. Aktualisht komuna e Ferizajt dhe ajo e Lipjanit nuk kanë asnjë inspektor sanitare, ndërkaq

komuna Prizrenit ka katër inspektorë, të cilët, në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), po kujdesën për zbatimin e masave të qeverisë për menaxhimin dhe parandalimin e pandemisë së koronavirusit në komuna.

Zyrtarë nga komuna e Ferizajt pohojnë se nuk kanë shumë informata sa inspekte dhe ndëshkime janë shqiptuar për mosrespektim të masave, pasi katër inspektorët sanitare nga niveli lokal kanë kaluar në AUV. Drejtori i Inspektoratit në këtë komunë, Hajrush Leka, thotë se nuk ka ndonjë informacion për inspekte, sepse nuk kanë kontaktuar me zyrtarë të AUV-it. Edhe komuna e Lipjanit, përveç mungesës së inspektorëve sanitare, përballet edhe mungesë të inspektorëve të fushave të tjera. Nga komuna e Lipjanit, dy inspektorë sanitare që kanë qenë të punësuar në komunë kanë kaluar në AVU, thotë Imer Rustemi, drejtor i Inspektoratit në Komunën e Lipjanit.

## Haradinaj uron Gjermaninë për Ditën e Bashkimit

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka uruar Gjermaninë për Ditën e Bashkimit. Haradinaj ka konsideruar se “Ribashkimi i Gjermanisë shënon fitoren e lirisë dhe demokracisë ndaj regjimeve totalitare dhe ishte një frymëzim dhe shpresë për popujt e shtypur kudo në botë”.

Në një shkrim të publikuar në rrjetin social “Facebook”, Haradinaj ka shkruar se “Gjermania e bashkuar u bë shembull i lirisë dhe demokracisë dhe kontributi i saj për paqe, siguri dhe stabilitet në botë vazhdon të jetë thelbësor”, duke shtuar se Gjermania “ishte përkrah

popullit të Kosovës në momentet më vendimtare, për çka jemi përjetësisht falënderues”. Haradinaj ka shprehur mirënjohje dhe falënderim për qeverinë dhe popullin gjerman, Ambasadën Gjermane në Kosovë dhe të gjithë gjermanëve që shërbejnë në Kosovë.



## Në Klinikën e Kardiologjisë vazhdon vendosja e pajisjeve elektrike të avancuara ICD

PRISHTINË, 3 TETOR - Në Klinikën e Kardiologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës me sukses të plotë po vazhdon puna e ekipit të Shërbimit të

Elektrostimulimit dhe Elektrofiziologjisë. Së fundmi janë vendosur tri pajisje elektrike të avancuara të zemrës, me funksion defibrilues dhe

kardiovertues (ICD) te pacientët me rrezikshmëri të lartë, me qëllimin kryesor trajtimin e aritmive jetëkërcënuese dhe parandalimin e vdekjes së

papritur. Vendosja e tyre vjen pas një “workshop” të suksesshëm të organizuar gjatë javës që lamë pas në Qendrën Kombëtare të Telemjekësisë.



# Kuvendi deri në fund të vitit pritet ta miratojë Ligjin për kriptovaluta

PRISHTINË, 3 TETOR - Deri në fund të vitit pritet që Kuvendi i Kosovës ta miratojë Ligjin për kriptovaluta i cili krijon bazë ligjore të përshtatshme për këtë industri të re në treg. Kuvendi, në këtë rast Komisioni Parlamentar për Ekonomi, i cili ka nisur iniciativën ligjore në korrik të këtij viti, ka kaluar fazën e parë të hartimit, ndërsa javën e ardhshme pritet që të mbahet një dëgjim publik për këtë nismë ligjore. Edhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK) kërkon që kjo industri për përfitime financiare, e cila operon jashtëligjshëm në Kosovë, të rregullohet një herë e përgjithmonë.

Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Ferat Shala, ka thënë se kanë kryer një hulumtim nga instancat profesionale të Kuvendit të Kosovës me qëllim, siç ka thënë ai, për të rregulluar këtë sektor i cili është jashtë kontrollit të shtetit. Shala ka

thënë se baza kryesore e kësaj industrie ilegale është në veri të Kosovës. Prandaj, kjo dukuri në veri thotë t'i ketë shtyrë për përshtatshme të krijimit të ligjit në fjalë. "E mira e kësaj është që në njëfarë forme të gjithë operuesit e këtij sektori do ta kenë të qartë se për një çast të caktuar ne jemi duke punuar, monitoruar dhe do t'i nënshtrohemi legjislacionit në fuqi. Shtu kësaj atë që kemi thënë edhe më herët, se kjo industri qendrën e zhvillimit të madh në Kosovë, pajisjet e tyre dhe teknologjitë e tyre i ka pasur krejtësisht në pjesën veriore të Kosovës. Shpenzimet e energjisë dhe mënyra e punës ilegale në atë zonë na ka bërë që ne ta shpejtojmë këtë çështje dhe të çojmë sinjal zyrtar dhe ligjor që nuk mund të ketë aktivitete të paligjshme në një qoshe të Kosovës, duke favorizuar kompani, të ardhura nga jashtë përmes rrugëve

ilegale dhe kontrabandimit të tyre, duke shfrytëzuar resurset dhe kapacitetet tona, objektet tona, energjinë tonë, në anën tjetër përsëri taksapaguesit e pjesës tjetër të vendit të kryejnë shërbime për energjinë që shpenzojnë", ka thënë Shala për "KosovaPress". Ai ka shtuar se fushata zgjedhore ka zbehur punën e Kuvendit të Kosovës për krijimin e ligjeve të reja, por konsideron se brenda këtij viti do të miratojnë Projektligjin për kriptovalutat.

Deputeti Shala ka thënë, po ashtu, se do të futin në këtë ligj një model sa më të përshtatshëm për këtë industri. "Konsideroj se do të shtyhet për vjeshtën e vonë, por besojmë shumë që të gjitha ligjet që kanë ardhur në komision tonë ne do të bëjmë maksimumin e mundshëm që t'i përfundojmë brenda këtij viti kalendarik. Problemi esencial i këtij ligji është që është diçka shumë e

re, nuk kemi shumë praktika të njohura, por edhe e veçantë është mënyra e operimit dhe e punës në këtë sferë të industrisë që dallon prej shteteve të mëdha të zhvilluara dhe shteteve perëndimore. Rajoni është më specifik, e kur i shtojmë specifikat që i ka edhe vetë Kosova si shtet i ri, atëherë do të kemi vërtet një punë të kujdesshme, por që i kemi analizuar disa rrethana dhe disa ligje model në mënyrë që në ditët dhe muajt e ardhshëm të mund t'i inkuorpojmë", shprehet ai.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, thotë se investimet në kriptovaluta janë të rrezikshme derisa rregullohet kjo çështje me ligj. Mehmeti thekson se për këtë projektligj duhet të merren parasysh edhe rekomandimet e Bankës Qendrore Evropiane. "Lëvizjet tona do të jenë karshi ose sipas

rekomandimeve që na vijnë prej Bankës Qendrore Evropiane. Ka pasur iniciativa prej Kuvendit të Kosovës dhe qëllimi është i mirë që të rregullohet kjo çështje një herë e përgjithmonë. As kuvendi si iniciues, por edhe ne si BQK ende nuk kemi një qëndrim të qartë për këtë, por mirë është të rregullohet. Se në çfarë forme ndodh kjo, besoj se edhe Kuvendi dhe të gjithë ne do t'i përcjellim rekomandimet që na vijnë prej Bankës Qendrore Evropiane në këtë drejtim, por mirë është që të rregullohet", thotë Mehmeti.

Përkundër që fenomeni i tregtimit të kriptovalutave mbetet ende çështje aktuale për përfitime financiare në Kosovë, sidomos nga të rinjtë, me gjithë rënien dhe ngritjen e vlerës monetare, qarkullimi i parave virtuale nuk është i rregulluar me kornizën e Bankës Qendrore të Kosovës.




## Ministri Murati publikon borxhet e 10 komunave, prin Gjilani me 10.45 milionë euro

PRISHTINË, 3 TETOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka publikuar borxhet e dhjetë komunave që kanë më së shumti obligime. Sipas Muratit, këto borxhe janë deri në fund të muajit gusht e, sipas listës, prin komuna e

Gjilanit me 10.45 milionë euro, ndjekur nga Ferizaj me 4.39 milionë euro dhe Mitrovica me 2.42 milionë euro. "Nisur nga interesimi i shtuar i mediave dhe publikut për borxhet e komunave, në vijim gjeni grafikonin që paraqet dhjetë

komunat që kanë më së shumti obligime të papaguara (sipas prerjes në fund të muajit gusht)", thuhet në njoftimin e Muratit. Nga kjo renditje, më së paku obligime të papaguara ka komuna e Skenderajt, vetëm 157 mijë euro.



# Nga floriri tek Bitcoin-i, ja si do të jetë e ardhmja e ekonomisë



**Nga Paola SUBACCHI  
"Nature"**

Doni të kuptoni arsyen pse qytetarët në El Salvador dolën të protestojnë në rrugë për miratimin e Bitcoin si një monedhë e ligjshme? Atëherë lexoni librin e ri të ekonomistit Eswar Prasad "The Future of Money" (E ardhmja e parasë).

Në të ai shpjegon se inovacionet në sistemet e pagesave dhe monedhat, pasqyrojnë si ndryshimet e rëndësishme në ekonominë botërore, pasi i integrojnë vendet e mëdha në zhvillim, si Kina, ashtu edhe transformimin gjithëpërfshirës dixhital.

Ndërsa zhvendosja e parave nëpër botë është bërë më pak e kushtueshme, Prasad analizon sesi inovacioni dixhital po e ndryshon atë si një mjet dhe një koncept. Këtë transformim e mishërojnë 2 gjëra. E para ka të bëjë me paratë si një entitet fizik. Dixhitalizimi i pagesave e sfidon idenë e parave të gatshme si forma më përfundimtare e parasë. Megjithatë transaksionet pa para ta gatshme, sjellin një humbje të privatësisë pasi ato lënë gjurmë elektronike. Por kjo gjë nuk duket të jetë një problem për shumicën e njerëzve dhe bizneseve që i kryejnë ligjërisht transaksione të tilla.

Dhe kërkimi i pagesave dixhitale për transaksionet mbi një shumë të caktuar, do të ndihmonte në tkurrjen e ekonomisë informale. Për shembull, në Itali ku kjo lloj ekonomie arrin në rreth 15 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, pagesat prej 2.000 eurosh apo më shumë nuk mund të shlyhen më në para të gatshme.

Qeverisja e të dhënave të mbledhura përmes transaksioneve dixhitale, mbetet një pyetje e hapur, e cila nuk mund të shpërfillet duke u cilësuar si produkt i paranojës libertariane mbi "ndërhyrjet e dëmshme ose të gabuara të qeverisë", siç thotë një analist. Ruajtja e lirive dhe privatësisë individuale, është një çështje legjitime në një shoqëri të hapur dhe demokratike, në të cilën shqetësimet mbi përdorimin e të dhënave personale trajtohen në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.

Prasad sheh përtej sipërfaqes së kësaj teme komplekse. Ai duket i kënaqur me perspektivën e zgjerimit të rregullimit ekzistues financiar. Për shembull, ai flet mbi rregullimin e këtij sektori dhe mënyrës se si dhe kur kompanitë e teknologjisë financiare (fintech) duhet të dorëzojnë të dhënat personale, në vend se të ri-mendohet i gjithë kuadri rregullator.

Aspekti i dytë i sfidës së parasë dixhitale, ka të bëjë me emetuesin e monedhës dixhitale dhe garancitë që ai jep. Në mënyrë konvencionale, monedhat e prodhuara dhe të garantuara nga bankat qendrore janë mjete të ligjshme. Për shembull, ato duhet të pranohen për shlyerjen e çdo detyrimi të borxhit ndaj një pale private.

Por sot kriptomonedhat e lëshuara nga subjektet private, veçanërisht Bitcoin, janë tashmë pjesë e një numri transaksionesh në rritje. Madje, Bitcoinu pranua për një kohë të shkurtër si një mjet pagese edhe nga prodhuesi i makinave elektrike Tesla, derisa kreu ekzekutiv i kompanisë, Elon Musk, u sensibilizua ndaj shqetësimit mbi ndotjen e madhe mjedisore që shkakton prodhimi i kësaj monedhe dixhitale.

Atëherë, kush apo çfarë është në rrezik këtu? Kriptomonedhat private janë para jo-konvencionale, gjë që do të thotë se vlera e tyre nuk mbështetet nga një aset i prekshëm siç është ari. Ato ndajnë disa tipare me monedhat që emetojnë bankat qendrore, si aftësia për të shlyer pagesat.

Por ndërkohë kriptomonedhave u mungon transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja. Ato janë më pak të sigurta (për shembull nëse

keni Bitcoin, dhe e humbni fjalëkalimin tuaj unik, ju e humbni përgjithmonë qasjen në llogarinë tuaj), ato janë më të paqëndrueshme, dhe nuk mund të sigurojnë të njëjtin nivel anonimiteti si paraja e gatshme.

Prasad arrin në përfundimin se kriptomonedhat private – sikurse është Diem i propozuar nga Facebook (i njohur më parë si Libra) – janë më shumë një modë sesa një kërcënim serioz ndaj parasë tradicionale. Ato ka të ngjarë të bëhen asete që do të zotërohen me tepër nga spekulatorët, në kushtet kur bankat qendrore po përgatiten tashmë që të hedhin në treg monedhat e tyre dixhitale.

Pavarësisht titullit "E ardhmja e parave" libri nuk merret vetëm me ndryshimet që do të ndodhin në shërbimet bankare dhe ato financiare. Prasad është shumë i interesuar për ndikimin social të dixhitalizimit të parasë, siç është bërja më gjithëpërfshirëse e financave. Sipas Bankës Botërore, gati 1.7 miliardë të rritur në mbarë botën nuk kanë llogari bankare. Ndër të tjera, kjo do të thotë se emigrantët që duan të dërgojnë para në shtëpi, mbështeten shpesh në shërbime dërgesash që janë shumë të shtrenjta ose tek lidhjet personale.

Fintech mund të ofrojë shërbime financiare të lira për të gjitha pjesët e shoqërisë, përfshirë familjet rurale, dhe ato

me të ardhura të ulëta. Për shembull, në Kenia shërbimi bankar mobil M-Pesa i prezantuar në vitin 2007, i lejon bizneset e vogla në zona të largëta që të ruajnë dhe transferojnë para në mënyrë të sigurt dhe të lehtë përmes telefonave celularë.

Ashtu si me të gjitha përpjekjet për të përcaktuar një të ardhme të pasigurt, edhe e ardhmja e parave lë hapur shumë pyetje. Gjithsesi në një pikë, Prasad duket i sigurt, se ndonëse paratë e gatshme do të bëhen më periferike, ato nuk do të dalin asnjëherë plotësisht nga përdorimi. Prasad e pranon se njerëzit duan që ta mbrojnë privatësinë e tyre.

Ai arrin në përfundimin se përderisa njerëzit e vlerësojnë komoditetin dhe anonimitetin, një shoqëri pa para të gatshme është jashtë çdo lloj diskutimi. Dhe në fakt është e vështirë të mos pajtohesh me të.

Heqja plotësisht dorë nga paraja fizike do të kërkonte ekzistencën e shoqërive plotësisht dixhitale, me një infrastrukturë të gjerë dhe të besueshme, një qasje universale në pajisjet dixhitale, dhe njerëz që janë të kënaqur me lënien e gjurmëve elektronike. Edhe pse pandemia ka sjellë shtimin e madh të pagesave dixhitale, mbase në çdo rast do të ishte mirë të mbajmë gjithmonë pak para të gatshme me vete. /Bota.ak




# Atdhedashuní e patrjotizëm

Nga: Ernest KOLIQI

Si popull ase bashkarí banorësh me të njëjtën zanafille qi flasin një gjuhë e ndjekin disa doke të përbashkta, na Shqiptarët jemi shumë të vjetër, – porsí komb ase bashkarí qytetarësh qi e dijnë edhe e ndiejnë veten pjesë të pandámë të një trapi shoqruer e politik strehues nën rendime shtetnore e norma ligjore të njëjshme, jemi të rij. Si popull, edhe kur jetojshim nën sundime të hueja, dridhej mbrenda nesh një instinkt, d.m.th. një prirje e nënvetedijshëme e zëmrës qi na shtynte me njëjtë si vllazën të gjithë ata qi kishin ndër fyza të njëjtin gjak; si komb përkundra na lidhë njënin me tjetrin, né Shqiptarët, jo vetëm një ndiesí zëmrë, por edhe një bindje e mendes se jemi pjesë gjindësh e dallueshme prej kombeve tjera, me vlera të veçanta shpirtnore. Kombi ká për gur themeli njëjtjen e plotë nga pjestarët e vet të drejtave e të detyrave qytetnore qi lëjojnë një bashkëjetesë të harmonishme. Kombi, për me u quejtë i tillë, duhet t'ushqejë në shpirt flakën e dashunís së ndërmjetvetëshme. Skáji atdhedashuní ka veshtrimin e një lidhjeje zëmrash (vetedije kombtare a coscience). Kush nuk ndien në gjak e nuk merr me mend domosdoshmënin e lidhjeve shëjte natyrore e shpirtnore ndërmjet qytetarve të një kombi, ai nuk áshat atdhedashës. Atdhedashuní nuk don të thotë dashuní për gurët lisat frymorët e një visí, por frymë bashkëjetese vëllaznore me njerz të njëjtës zanafille e gjuhe e dishresh qi banojnë n'at rreth natyruer. Prandej fjala "patriot" duhet përdorë vetëm për të cilësue një njeri i cili kryen vepra të shqueme për vend e për bashkatdhetarë të vet. Atdhedashës e kemi për detyrë të jemi të gjithë; patriotë janë ata qi me therorína a vepra të nalta të jashtazakonshëme i sjellin dobína landore e morale të mëdhaja kombit. Kët lloj parathënie nuk po e rrjeshtoj për të tregue se sa i hollë jam në dallime përfimesh, por për t'i a sqarue vetes e ndoj lexuesit qi mirësisht ndjek këto shënime të mija në krye të Shëjzavet, sjelljen e një bashkatdhetari, i cili para pak ditve m'erdhi në shtëpi për një pjekje oborrsije (visite de courtoisie). E kishem takue, për rrëshqit edhe disa herë tjera, por at ditë pata përshtypjen se po e shof për të parën herë. Hyni n'odë t'eme të shkrimit me një farë t'ecunit të madhnueshëm e si me një qindrim theatral. M'u duk se hyni para tij një kravatë me vija të trasha kuq e zí. Si zúni vend në një

ndeje pranë tryezës s'eme të punës, më hoq vërejtjen edhe një dalluese (distinctif) qi kishte n'ilik a thile (boutonnière) të setres me një shqipe të zezë kraha-shtërme në fushë të kuqe. Petkat e shtatit m'u duken jo fort të pastra, këmisha e koleti të palám, çarapët e lëshuem zharg mbi neje të kambve e këpucët e pafshíme. Përkundra ishte rrue e krue dhe flokët i ndritshin prej brilantinës. Mund të kishte, mbas hamendje, një moshë tridhetë-vjetsh ase aty pari. Vinte nga një kamp profugësh t'afërsinave të Romës. Ndër kampe gjinden fatosa autentikë të luftës antikomuniste, me varrë ende të pambylluna në shtat, qi pësuen humbje në shpijarë e në pasuní dhe nuk ankohen as nuk mburren për shka bânë. Për këtë, qi më rrinte para, s'kishem ndëgjue se ish therorzue në ndonji mënyrë të veçantë. Nisi të flasi me një siguri krenare. Kuptohej se e mbante veten njeri të rrahun me shekull e të randësishëm, e t'afte me përballue mjerisht çdo rasë të jetës. Mbas shumë fjalësh të shprazta: (Po si po jë me shëndet? Po robët si m'i kè? A po mërzhitesh? A po lodhesh me punë? etj. etj.) e flakroi pyetjen qi, mbas mendes së tij, do të hapte një bisedë të gjânë e tërthjeksë. Si të duket, zotní loci, se po shkon kjo puna e jonë? A ka ndoj shpresë se lot gjá për së shpejtí? Për besë, lum miku, nuk di shka me të thánë. Çashtja e Shqipnis ka hy në qark të lojës së madhe botnore, e duhet me pá se ç'farë zhvillimi merr gjendja ndërkombtare e përgjithëshme... Kam ndëgjue... unë s'i marr vesht gazetát e hueja... me zí qi këndojo ato të shkrueme shqip... por flitet në kamp se Kina po na dashka me u lidhë me Gjermanín prendimore... Mundet qi don me hy në marrëdhënie ekonomike... Jo, jo, don me i bashkue Gjermanët dhe me u lidhë për së forti me ta. Kjo punë né Shqiptarvet t'ikun na dëmton ke s'Ve. Forcohen të kuqët në Shqipni... Shka me i u përgjegjë? Prej kah me e zënë fill arsyetimin e si me ardhë tue i a shtjerrtue për t'a bindë se deri sa parabola e regjimit të sotshëm t'arríjé në fund të harkut të vet, Shqipni ja do të përshkohet nëpër një varg fazash herë ngitëse herë zbritëse gjithënjë nën ndikimin e ngjarjeve ndërkombtare, të cilat janë në një shtjelli (évolution) të vrullshme. I a bána, sa për të thánë dishka mbasi rrinte në pritje të një përgjegjeje: Paj, me kallzue të drejtën, sot, si erdhen tue u ndërlikue punët, nuk po din njeriu shka me dishrue, sepse ka keq e má keq. Lë qi përgjithësisht çashtja shqiptare



nuk áshat në dorë të Shqiptarvet e prandej na s'kemi shka të bájme në këtë fazë të tashme; por, edhe sikur të kishim ndoj mundësi veprimi, shka me bá? Si? Shka me bá? Me mbledhë burrat e mërgimit, me zhgarkue në Shqipni e me sulmue ata... Por s'kemi parí... Po të kishte patriotja në krenë të mërgatës si ká në vogjëli të kampeve, ndryshej kishte për të vojtë kjo punë e jonë... Kah i shqiptonte këto fjalë me theksim, m'u duk se po qitshin shkëndíja ngjyrat e kravatës në gjoks dhe të dallueses në skjep të setres si edhe brilantina në kokë. Na qi e njehim veten të pajisun me një farë kulture e mirëritjeje, e kemi për detyrë të siellemi me durim e kuptim të mirësishëm kundrejt bashkatdhetarve të pashkolluem, edhe kur këta ngrehen plot mburje në mproje të gjikimeve pa themel të tyne. U përpoqa sa mujta, tue i a thjeshtësue pikat e çashtjes, me i a mbushë mendin qi nuk áshat punë e lehtë organizimi i një veprimtaríje kryengritëse, sepse jo vetëm mungojnë mjetet, pregatitja teknike, vendi i huej për piknisje, por mungon sidomos siguri ja në pasoja, të cilat mund të jenë shumë të dâmëshme për ardhjen e kombit. Shkurt, – përfundova:– mund të biejmë prej shiut në breshën. Natyrisht flas tue marrë në shqyrtim rrethanat ashtu si janë sot; nesër mund të paraqiten ndryshej... Ai ja nuk e kuptoi fillin e arsyetimit t'em ja e gjikoi krejt të papëlqyeshëm, pse, fryni gjoksin dhe e ngrehi përpara: prej setres së zhbërthyeme i dilte jashtë këmisha ku spikatshin ngjyrat e kravatës me vija të trasha të kuqe e të zeza. Fsháni me të dhánun e tha me një ton eproríje mburracake:–Po shof se s'paskan mbetë patriotja në parí: kryeparët janë kah e marrin në qafë vogjëlin... Na vëjmë për Shqipni ndër kampe e ata bájne pall ndër qytete. I kanë sigurue punët e

tyne... Shka po u duhet me u tundue!... Zotnova mbrenda vetes një shkas idhnije qi qe tue shpërthye përjashta me turr. Ishte mik në shtëpi t'eme. Lypej durim. Noblesse oblige. Mbas një ndalimi të shkurtë, i a këtheva: Má meritë kanë ata qi ngelne në Shqipni e qindrojnë heshtazi në parime të shëndoshta shqiptare nën ndrydhjen e sundimit gjakatar se të gjithë na qi në Prendim qoftë po edhe me vështirsina, por me líri të plotë rrijmë tue pritë ditën e çlírimit t'atdheut...

## Ai nisi tash me sulmue drejt për së drejtí:

Mirë: ata vëjnë mbrendë e na të kampeve vëjmë jashtë: mësá qi ju, më duket, nuk jeni kah mërzhiteni aspak tue pritë çlírimin... S'mund u prita pa i a shkrepë:

Atëherë ti qi vuen në kamp e njehke veten patriot: unë qi do të lodhi mend e trup jashta kampit për të sigurue bukën e përditëshme të shpëtíjakvet të mij, unë qênkam njeri i dobët mbas mendimit t'and...

S'po tham këtë, e s'due me fye zotnín t'ande, por áshat e vërtetë qi unë jamë tue vëjtë për Shqipni e disa tjerë përjashta jetojnë rahat...

## Prap e ndala veten e, butësisht, i thashë:

Shif, lum miku, mue e ty e të gjithë Shqiptarët na ka vrá Zoti e jemi për t'u qá me lot, të gjithë, pa asnjí dallim. Fatkeqsinat njána mbas tjetres pa më asnjí herë po shkrepën mbi né. Por kjo nuk na lëjon me e përbuzë Shqipni pse ka qillue e pa fat. Kush i a sjellë shpinën nánës së vet pse e shkreta nuk mundet me i sigurue fat e të mira vetes e krijatyravet qi i dalin nga prëhni? Mun, pse áshat në mjerim, do t'a duem atdhen má tepër. M'e dashtë e kemi për

detyrë, si pari ja ashtu voglija, si po thue ti, dhe, tue e rrethue me të gjitha ndiesít e zëmrës s'onë, nuk kryjmë një punë të jashtazakonshëmë: i japim Nánës së Përbashkët të drejtën qi i përket. Prandej atdhedashunija nuk t'ep të drejtë për shpërblime landore e morale. Patriotizmi áshat tjetër gjá, sepse kapërcen masën e detyrave kombtare e shoqnore të rendomta dhe áshat një përpjekje heroike në të cilën lulzojnë shkëlqimisht vetít má të nalta njerzore. Si janë shëjtent e martírët në fê, ashtu janë patriotat e deshmorët në kombsi. Për shembull patijota quhen Jeronym De Rada qi shkruí münd e pasuní për të ndezë në shpirtent e Shqiptarvet dishirin e líris dhe të rilindjes kombtare tue dekë në skamin má të mjerueshëm; Oso Kuka qi vullnetarisht shkoi me mprojtë caqet e shugurueme t'atdheut dhe, i rrethuem prej një moríje anmiqësh, kur s'ishte aspak korí me u dorzue, i dha zjarm barotit të kullës ku bânë qindresën e vdiq trimnisht, tue hjedhë për havá veten e shumicën e rrethuesavet; Ded Gjo' Luli, qi i joshun e i përkëdhelun prej anmiqësh të kombit, s'pranoi as nderimet as dhuratat e tyne, kur ata e ftuen me u lëshue dorë të lírë në pushtim të tokave shqiptare, dhe me këtë sjellje i shkaktói vetes salvime e vdekje: Papa Kristo Negovani qi pohoi të drejtat e shqiptarizmit përball urdhnavet Fanarit tue e pague me krye qindrimin e tij guximtar. Këtyne u jepet ligjisht emni patriot. Unë, ti, shumica, dikush tue vëjtë ndër kampe ase n'at burg të madh në të cilin tyranija e kuqe e shëndrroi Shqipni e sotshëme, dikush tue derdhë mund shqisuer (intellectuel) për të mbajté pozitát kulturore kombtare, tinzë mbrenda e botnisht jashta atdheut, shumë shumë jemi të dënjë të quhemi atdhedashës jo patriotja. E atdhedashuníja tregohet me punë jo me reklame e përligjerime (déclamation) e shëje të jashtme ase tue kërkue shpërblime e të drejta në mërgim ku sjeçili iron si mbas riskut të vet dhe të zotsis vetjake. Ai piu kafen dhe u çue e duel.

## Besoj se, tue dalë, do të këtë thánë vetmevetí:

E kanë kollaj këta me i rrotullue fjalët si mbas qejfit. Gjuha áshat tulit. Po, na patriotët, duhet të bájme punën t'onë! N'anë tjetër unë mendojshem, kur shkoi: – Pak çmohet veprimtaríja kulturore. Ai, i ngrati, vuen ndoshta fizikisht, por na shkrimtarët e pakuptuem vëjmë shpirtnisht. Fati na ka dënue né Shqiptarvet mos me u kuptue me shoqishojnë e me vëjtë i madh e i vogël! /"Shëjzat", 1964/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Drita ndan pikët me Prishtinën, fitojnë Llapi dhe Feronikeli

Derbi në mes të Dritës dhe Prishtinës nuk solli fitues e as gola, kurse në këtë ndeshje debutoi Besart Berisha. Llapi e shijoi fitoren e parë në këtë kampionat, pasi e mposhti Dukagjinin. Tri pikë rrëmbeu edhe Feronikeli në përballje me Ulpianën

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 3 TETOR** - Të dielën është mbyllur java e tetë e BKT Superligës së Kosovës në futboll. Derbi i kësaj jave ndërmjet Dritës dhe Prishtinës është mbyllur pa fitues dhe pa gola. "Mendoj se derbi e arsyetoi këtë epitet, pasi ishte 'luftë' nga të dyja skuadrat. Kundërshtari nuk arriti të na rrezikojë shumë. Kishim raste më të mira shënimi, por nuk arritëm t'i konkretizojmë. Ishte ndeshje e taktizuar. Kemi pritur gabimin për t'i ndëshkuar kundërshtarët. Kemi mundur ta fitojmë ndeshjen, por nuk e arritëm një gjë të tillë", ka deklaruar trajneri i Dritës, Ardian Nuhui. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin e qytetit në Gjilan nuk solli lojën që pritej prej këtyre dy skuadrave dhe, si rrjedhojë, edhe rastet për gol

ishin të pakta. Ky ishte barazimi i tretë për Dritën në këtë edicion, ndërsa për Prishtinën barazimi i katërt. Drita është e pesta me 12 pikë, kurse kryeqytetasit renditen në vendin e gjashtë me 10 pikë. "Nuk kishte shumë hapësira në këtë ndeshje. Kishim më shumë guxim, sulmuam dhe tentuam të arrijmë deri te fitorja. Kemi ardhur për fitore, por të dyja ekipet ishim të kujdesshme. Futbollistët u angazhuan më shumë, tentuam të fitonim takimin, por nuk e arritëm një gjë të tillë", ka thënë trajneri i Prishtinës, Zekirija Ramadani. Në ndeshjen tjetër skuadra nga Podujeva, Llapi, e ka shënuar fitoren e parë në këtë edicion, duke e mundur Dukagjinin në Merdar me rezultat 1-0. Golin e vetëm në këtë ndeshje e ka shënuar meksikani Francisco Rivera në minutën e 12-të me



gjuajtje me kokë pas harkimit të Bujar Idrizit. Llapi edhe pse arriti fitoren e parë, vazhdon të jetë në pozitën e fundit me 6 pikë. Fitore minimale ka arritur edhe Feronikeli ndaj Ulpianës (1-0). Golin e vetëm të këtij takimi e realizoi Drilon Leka në minutën e 26. "Nikli" ka grumbulluar dhjetë pikë dhe është në vendin e shtatë, kurse Ulpiana është në vendin e parafundit me 6 pikë. Të shtunën fitore me përmbysje ka shënuar skuadra e Ballkanit në ndeshjen ndaj Drenicës (3-2). Kuqezinjtë e Skenderajt krijuan

epërsi prej dy golash, por vendasit arritën të përmbysin gjithçka në pjesën e dytë. Golat për Drenicën i shënoi Kreshnik Uka në minutën e 25-të dhe të 55-të nga penalltia, derisa shënues për vendësit ishin Astrit Thaqi në minutën e 61-të, Rustem Hoxha në minutën e 71-të dhe Armend Thaqi në minutën e 83-të. Pas këtyre tri pikëve, Ballkani është rikthyer në pozitën e parë me 16 pikë. Ndërsa kuqezinjtë janë në vendin e dytë me 14 pikë. Skuadra që po befason të gjithë

### SUPERLIGA - JAVA 8

Drita - Prishtina	0-0
Llapi - Dukagjini	1-0
Feronikeli - Ulpiana	1-0
Ballkani - Drenica	3-2
Malisheva - Gjilani	1-1

### Tabela

1. Ballkani	16 pikë
2. Drenica	14
3. Gjilani	13
4. Malisheva	12
5. Drita	12
6. Prishtina	10
7. Feronikeli	10
8. Dukagjini	6
9. Ulpiana	6
10. Llapi	6

me rezultate pozitive, Malisheva, ka mbetur baras me Gjilanin (1-1). Të parët në epërsi kaluan vendasit me golin e Marc Olivierit në minutën e 67, ndërsa baraspeshën në rezultat e riktheu Gerhard Progni në minutën e 74-t nga penalltia.

## Kelmendi për eliminimin në Lojërat Olimpike: Ishte dita më e keqe e jetës sime

**PRISHTINË, 3 TETOR** - Kosova shpall pavarësinë në vitin 2008, por nuk u njoh nga IOC deri pas Lojërave Olimpikë të Londrës, ku ajo përfaqësoi Shqipërinë. Medalja e artë olimpikë e Majlindës ishte e para për Kosovën. Fakti që ishte e artë ishte edhe më i madh. Ajo vendosi standardin për pjesën tjetër të ekipit të saj që tashmë po merrte medalje. Ekipi i xhudos i Kosovës bëri përparim dhe në Tokio ka fituar dy medalje të tjera të arta të cilat ishin të paimagjinueshme një dekadë më parë. Diçka që ata patjetër e ndiejnë është se motivimi i tyre erdhi nga forca e Majlindës dhe trajneri i tyre, Driton Kuka. Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova kishin ditën e jetës së tyre në Tokio, dhe megjithëse Majlinda shpresonte ta gjente veten në podium, eliminimi i saj në raundin e parë ishte një tronditje e madhe për të dhe për pjesën tjetër të komunitetit të xhudos. E shkatërruar nga dëmtimet dhe operacionet e njëpasnjëshme që nga viti 2015, ajo mendoi se pandemia do të ishte shpëtimi i saj, se ajo do të

kishte kohë të shërohej dhe të kthehej në gjendjen kulmore, por një operacion në gju në shtator 2020 provoi të kundërtën dhe e ktheu atë në gjendjen në të cilën ishte. Fatkeqësisht, kjo ndikoi në mentalitetin e saj deri në pikën që ajo ishte e pasigurt se mund të garonte edhe në Lojërat e saj të treta Olimpikë. Trajneri Driton Kuka mendoi se ndoshta humbja e kampionateve evropiane dhe botërore do të ishte në rregull pasi ajo ishte ende e kualifikuar, por kur ajo tha në janar se do të humbiste të gjitha garat, ai kuptoi se ata po bënin një lloj bisede tjetër. Përfundimisht, ajo kuptoi se ishte e rëndësishme për ekipin që ajo të vazhdonte në Tokio dhe pavarësisht se ndihej mjaft mirë e përgatitur, aq sa për të gjetur pak lumturi në Budokan, nuk ishte ashtu. Ajo nuk ishte në gjendje të përmbushte qëllimet e saj personale dhe për këtë, ajo thotë se nuk ka një përgjigje, në njëfarë mënyre tingëllon sikur e përndjek, se ajo mund të mos ketë kurrë një përgjigje për të dhënë. "Ndjeva sikur çdo gjë u



shkatërrua (qan). Nuk e di, por ende nuk mund ta kuptoj pse shkoi ashtu. Diçka duhej të funksiononte. Nëse jo eksperiencia ime, atëherë përgatitje fizike. Tani provoj që të mos e mendoj atë sepse nuk kam

përgjigje. Ishte dita më e keqe e jetës sime", ka thënë Majlinda Kelmendi. Megjithatë, sukcesi ekstrem i ekipit është diçka në të cilën ajo mund të marrë ngushëllim, duke qenë pjesë e ekipit të vogël që ka mahnitur

botën. Një gjë e rëndësishme për Majlindën është se ajo nuk pendohet. Ajo mund të mos e ketë kaluar ditën e saj, një krahasim i ashpër me përvojën e saj në Rio, por ajo që ka është një bibliotekë e kujtimeve të bujshme që përshijnë gjithë karrierën e saj. Duke reflektuar për kohën e saj në Tokio, ajo tani e di që të mos shkonte do të ishte një gabim i rëndë, diçka për të cilën do të ishte penduar dhe do të vinte në dyshim gjatë gjithë jetës së saj, "çfarë nëse" varej mbi të. Për familjen, klubin, vendin dhe komunitetin e xhudos ajo është një heroinë, duke udhëhequr ekipin e Kosovës përkrah trajnerit të saj Driton Kuka, me shokët e saj të skuadrës që e presin në krahë, duke e mbështetur në çdo hap të rrugës. Ky klub i lidhur ngushtë do të vazhdojë ta bëjë këtë, të mbështesë njëri-tjetrin në momentet e tyre më të mira dhe më të këqija. Majlinda nuk kishte asgjë për të humbur në Tokio dhe ndihmoi ekipin e saj të fitonte më shumë nga sa ëndërronte. Ne do të presim për të parë se çfarë do të sjellë e ardhmja.

## Koemani nuk frikësohet nga shkarkimi: Kam besimin e Laportës

**BARCELONË, 3 TETOR** - Barcelona ka pësuar një tjetër humbje. Këtë herë është mposhtur me rezultat 2-0 nga Atletico Madridi. Trajneri holandez i Barcelonës, Ronald Koeman, ka deklaruar se nuk largohet nga klubi, pasi ka mbështetjen e presidentit Joan Laporta dhe dëshiron ta ringrehë Barçën. "Asnjëherë nuk është vonë. Është e rëndësishme të sqarohet rruga që duhet ndjekur. Me ose pa mua si

trajner. Nuk mund të punosh nëse nuk ka qartësi në këtë drejtim. Të premten i telefonuam njëri-tjetrit dhe dje folëm gjatë. Për ekipin, klubin, për situatën time. Kam kërkuar që klubi ta bëjë të qartë situatën time. Është e rëndësishme që dhoma e zhveshjes të dijë situatën. Presidenti e ka bërë të qartë vendimin e tij", ka thënë Koeman. "Ky presion ekziston gjithmonë, por ndiej

mbështetjen. Ndjesia është pozitive. Kam besim, por varet shumë nga rezultatet. Nuk kemi rrezikuar me Albën. Shpresoj që Ansu Fati të jetë më mirë fizikisht. Shpresoj që edhe Aguero dhe Dembele të jenë më pranë kthimit. Ne e dimë çfarë na mungon, sidomos në sulm. Ne luajmë përpara me mesfushorë. Donim të luanim me stilin tonë, por nuk mundëm", ka shtuar Koeman.



## Sfidat për Superkupë

**PRISHTINË, 3 TETOR** - Palestra 'Karagaçi' në Pejë do të jetë arenë e ndeshjeve të Superkupës së Femrave. Më 4 dhe 5 tetor do të përballen katër skuadrat më të mira në basketbollin e femrave. Më 4 tetor nga ora 16:00 sfidohen Penza - Vëllaznimi, kurse nga ora 19:00 Prishtina - Vëllaznimi. Finalja zhvillohet më 5 tetor nga ora 19:00. Kapitenia e Penzës, Valbona Bytyqi, ka folur për gjysmëfinalen ndaj Vëllaznimit. "Përgatitjet kanë shkuar shumë mirë. Vajzat kanë disponim të mirë. Me ardhjen e trajnerit Bujar Loci dhe përforcimet jemi duke bërë një punë të mirë si ekip. Synimet tona si gjithmonë janë që të fitojmë Superkupën dhe të përgatitemi për Kampionatin e Kosovës, po ashtu ta përfaqësojmë vendin dhe qytetin sa më mirë në Ligën Unike", është shprehur Bytyqi për faqen zyrtare të FBK-së. Trajneri i Vëllaznimit, Pal Sylja, është shprehur se, edhe pse nuk e kanë skuadrën si edicionin e kaluar, nuk udhëtojnë me flamur të bardhë. "Për dallim nga edicioni i kaluar, kemi bërë disa ndryshime. Ne jemi munduar të përgatitemi sa më mirë për Superkupë, që është shumë e rëndësishme. Sigurisht nuk udhëtojmë me flamur të bardhë dhe do të përpiqemi ta japim më të mirën tonë kundër Penzës. Angazhimi nuk do të mungojë dhe do të përpiqemi ta japim më të



mirën në gjysmëfinale të Superkupës", është shprehur Sylja për faqen zyrtare të FBK-së. Basketbollistja e Bashkimit, Irma Konjusha, ka folur për synimet dhe Superkupën. "Përgatitjet kanë shkuar shumë mirë deri më tani me trajnerin e ri. Kemi bërë disa ndryshime të mëdha në ekip, përforcime të rëndësishme, qofshin ato vendore dhe të huaja dhe mund të them se jemi kompletuar si ekip dhe jemi gati për edicionin e ri. Natyrisht, synimet janë që të luftojmë për trofe, mbi të gjitha të kemi paraqitje të mira si ekip. Mendoj se jemi gati për turneun e Superkupës dhe duam të kemi një fillim të mirë. Natyrisht, nuk do të jetë lehtë sepse respektojmë të gjitha skuadrat e tjera. Sigurisht,

synim mbetet trofeu i Superkupës për ta nisur edicionin e ri me këmbë të mbarë, por mbetet të shihet. Më e rëndësishmja është se të gjitha ekipet janë përforcuar dhe na pret një edicion interesant jo vetëm në kampionatin tonë, por edhe me pjesëmarrjen në Ligën Unike", ka theksuar Konjusha. Basketbollistja e Prishtinës, Enxhi Khanaj, ka folur para duelit ndaj vashave prizrenase. "Ekipi ka formë të mirë dhe po bëhet kompakt çdo ditë e më shumë. Kemi një gjysmëfinale me një kundërshtar që ka treguar cilësi kohët e fundit në basketbollin e femrave, por ne jemi entuziastë dhe optimistë për ndeshjen dhe për Superkupën në përgjithësi, pasi ekipi është përgatitur me seriozitetin dhe vlerësimin e duhur. Ekipi i Prishtinës është formuar me mentalitet të fitores dhe ky vit nuk bën përjashtim, pasi ky është synimi ynë. Është e rëndësishme që stafi dhe të gjitha lojtarët do të japin maksimumin në fushë", nënvizoi basketbollistja nga Shqipëria.

### Orari

Më 4 tetor takohen:  
16:00 Penza - Vëllaznimi  
19:00 Prishtina - Bashkimi

Më 5 tetor takohen:  
19:00 Finalja

## Reja shpall listën e kombëtares për ndeshjen me Hungarinë dhe Poloninë

**TIRANË, 3 TETOR** - Trajneri i Kombëtares shqiptare, Edoardo Reja, ka bërë publike listën me emrat e 25 lojtarëve që do të grumbullohen për dy ndeshjet e eliminatorëve të Botërorit "Katar 2022" ndaj Hungarisë dhe Polonisë. Lista kuqezi ka pak ndryshime në krahasim me grumbullimin e fundit, teksa risia është rikthimi i Ivan Balliut, i cili po kalon një formë të mirë me Rayo Vallecanon në Spanjë. Ndërkaq, rikthehen në dispozicion Ermir Lenjani, Kastriot Dermaku dhe Federic Veseli, të cilët munguan në ndeshjet e fundit për shkak të problemeve fizike. Do të mungojnë për shkak dëmtimi këtë herë mesfushorët Qazim Laçi dhe Armir Abrashi, i cili është dëmtuar pak ditë më parë dhe nuk do të ketë mundësi të japë kontributin e



tij për kuqezinjtë. Pjesa tjetër e listës nuk ka ndryshime, teksa pas impenjimeve me klubet në

### Lista e lojtarëve

Etrit Berisha, Thomas Strakosha, Gentian Selmani, Elsie Hysaj, Ivan Balliu, Ardin Ismajli, Berat Gjimeshi, Marash Kumbulla, Enea Mihaj, Ermir Lenjani, Lorenc Trashi, Federic Veseli, Erjon Hoxhallari, Kastriot Dermaku, Enis Çokaj, Klaus Gjasula, Ylber Ramadani, Keidi Bare, Odise Roshi, Endri Çekici, Nedim Bajrami, Bekim Balaj, Armando Broja, Sokol Cikalleshi, Rei Manaj, Myrto Uzuni.

fundjavë lojtarët do të grumbullohen të hënë në kompleksin Tropikal në Durrës për t'i nisur përgatitjet për dy ndeshjet e radhës që janë vendimtare për kombëtaren në eliminatorët e Botërorit. Shqipëria renditet aktualisht e dyta në Grupin I me 12 pikë pas 6 ndeshjesh, ndërsa më 9 tetor do të sfidojë Hungarinë në transfertë. Më 12 tetor në "Air Albania" kuqezinjtë do të presin Poloninë, aktualisht rivalin direkt për vendin e dytë.

### SHKURT

#### Berisha shënon golin e parë në Turqi

Sulmuesi shqiptar Mërgim Berisha ka shënuar golin e parë me fanellën e Fenerbaçes që pas transferimit këtë verë nga skuadra e Salzburgut. 23-vjeçari shënoi golin e parë për gjigantët turq në sfidën ndaj Kasimpasas duke e kaluar në avantazh në minutën e 16. Ky është goli i parë për Berishën me fanellën e Fenerbaçes duke e bërë sefte në Superligën turke. Vetëm katër ndeshje ka luajtur 23-vjeçari me Fenerbaçen, ndërsa më parë ka mbajtur veshur fanellën e Salzburgut, Altaçit, LASK-ut e Liferingut.

#### Deschamps mbështet Benzemën për 'Topin e Artë'

Debati mbi atë se kush duhet të fitojë Çmimin e "Topit të Artë" 2021 vazhdon dhe pa një favorit të qartë ndryshe nga vitet e mëparshme. Kur u bë pyetja nëse Benzema ishte një kandidat serioz për "Topin e Artë", Didier Deschamps ishte i qartë, shkruan "Marca". "Po, gjithsesi", ka deklaruar Deschamps në një konferencë shtypi. Kylian Mbappe shihet, gjithashtu, si një fitues i ardhshëm i "Topit të Artë" dhe trajneri francez është i bindur se, gjithashtu, Mbappe do ta fitojë atë në një moment në karrierën e tij. "Po, me siguri", u përgjigj Deschamps për shanset e Mbappes. Franca do të përballë me Belgjikën në gjysmëfinalen e Ligës së Kombeve më 7 tetor dhe Benzema është bërë një lojtar i rregullt në formacionin startues për Les Blues. Marrëdhënia në mes të Deschamps dhe Benzema është rregulluar pas shumë vjetësh mosmarrëveshje, me formën e lojtarit të Real Madridit që është bërë e pamundur të injorohet.

#### Vdes ish-presidenti i Olimpikut të Marsejës

Është ndarë nga jeta në moshën 78-vjeçare ish-presidenti mitik i Olimpikut të Marsejës, Bernard Tapie. Biznesmeni i shquar dhe ish-ministër në kohën e presidentit Mitterrand, mbylli sytë përgjithmonë mëngjesin e së dielës, pasi humbi betejën me sëmundjen e rëndë të kancerit, që e kishte prekur në stomak që në vitin 2017. Një nga personalitetet më të njohura dhe më të diskutueshme të Francës në vitin 2016 kishte një pasuri të vlerësuar prej 150 milionë eurosh. Bazuar në deklaratën e familjes, ai do të prehet në Marsejë, në "qytetin e zemrës së tij". Pengu i vetëm që i kishte mbetur, që ka deklaruar në intervistën e fundit për "Le Monde", ishte fakti që nuk ka mundur të bëhet kryetar bashkie. Olympiku i Marsejës postoi një mesazh në rrjetet sociale, për t'i dhënë "me trishtim të thellë" lamtumirën ish-presidentit të famshëm, nën drejtimin e të cilit skuadra marsejeze fitoi Ligën e Kampionëve në vitin 1993.

#### Suarez: Festa e golit nuk ishte kundër Koemanit

Luis Suarez u hakmor ndaj Ronald Koeman të shtunën në mbremje, duke shënuar golin e dytë të Atletico Madridit në fitoren 2-0 ndaj ish-klubit të tij, Barcelonës. Uruguaiianit iu tha se ishte i tepërt nga Koeman përmes një telefonate. Suarez, pasi shënoi të shtunën, bëri një gjest telefonik dhe, pas lojës, shpjegoi në mënyrë kritike se kujt i drejtohej, edhe pse mohoi se ishte për ish-trajnerin e tij. "Ishte për njerëzit që e dinë që unë kam të njëjtin numër dhe se unë jam ende duke përdorur të njëjtin telefon. Nuk ishte për Koeman, aspak. Nëse doni të dini, unë kisha bërë shaka me fëmijët e mi se do ta bëja këtë", ka thënë Suarez, i cili nuk e festoi golin e tij për shkak të respektit të tij për Barcelonën. "Unë tashmë e dija se nëse shënoja do të kërkoja falje. Për shkak të respektit, dashurisë sime, për të qenë një tifoz tjetër i Barcelonës, për karrierën që kam pasur në Barcelonë, për periudhën që po kalojnë kolegët e mi, e cila është e vështirë, dhe tifozët. Nga respekti", ka shtuar Suarez.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588  
+381(0)390/324 034  
www.cabrati.com  
e-mail. info@cabrati.com  
Gjakovë - Gjakova

**K.R.M. "ÇABRATI"**

Në bazë të nenit 21 paragrafi 21.4 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087, si dhe Plotësim Ndryshimi i Ligjit mbi NP Nr. 04/L-111 si dhe nenit 21, paragrafi 21.3 të Statutit të Ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve i KRM "Çabrati" Sh.A, në mbledhjen e mbajtur me 28.09.2021, vendosi që me datë 04.10.2021 të publikoj këtë:

### KONKURS

**Pozita:** Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit.  
**I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve.  
**Vendi i Punës:** KRM "Çabrati" Sh.A, Gjakovë.  
**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.  
**Kohëzgjatja:** Tri (3) vite, me mundësi vazhdimi.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Zyrtari Kryesor Financiar do të menaxhojë, nën udhëheqjen e Kryeshefit Ekzekutiv punët financiare të kompanisë, dhe duke marrë parasysh limitet e vëna nga Bordi i Drejtorëve do të ketë autoritetin për të lidhur kontratë për kompaninë në të gjitha transaksionet financiare dhe do të jetë përgjegjës për:
- T'i mbajë llogaritë e kompanisë të azhuruara dhe të sakta;
- Të ngrejë dhe të drejtojë të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjen, pranimin e parave dhe asetëve themelore;
- Të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjeve të veçanta;
- Të shqyrtojë shpenzimet e punëtorëve për të siguruar përputhje me politikën korporative dhe buxhetin para se të paguajë;
- Udhëheq dhe këshilloj gjithë personelin varës për të siguruar rezultate efektive;
- Shqyrton dhe aplikon ligjet dhe procedurat e ATK-së që rregullojnë çështjet tatimore dhe kujdeset për zbatimin me përpikëri të tyre;
- Koordinon, kontakton dhe bashkëpunon në ofrimin e të gjitha llogarive dhe raporteve që kanë të bëjnë me ATK-në, dhe proceset e kontrollit që kryejnë institucionet tatimore;
- Analizon klimën financiare dhe tendencat e biznesit për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen;
- Interpreton informacionin financiar për të siguruar raportet e nevojshme për vendimmarrje të Bordit të Ndërmarrjes;
- Monitoron rrjedhën e parasë, llogaritë dhe transaksionet e tjera financiare;
- Mbikëqyr ndihmësit financiar dhe punonjësit e tjerë në lehtësimin e operacioneve ditore, duke përfshirë ndjekjen e të dhënave financiare;
- Bashkërendon punët me Njësinë e Burimeve Njerëzore në rekrutimin e stafit të rinj në kuadër të Sektorit Financiar;
- Bashkërendon punët me Burimet Njerëzore në vlerësimin e performancës së punëtorëve në kuadër të Sektorit;
- T'i përgatisë të dhënat e kompanisë për auditimin e fundvitit;
- Të shqyrtojë, organizojë prokurimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha politikave të sigurisë që kanë të bëjnë me afarizmin;
- Të koordinojë funksionet tjera të biznesit siç është dhënie me qira e ndërtesës dhe pajisjeve, si dhe blerja me Kryeshefin Ekzekutiv dhe zyrtarin e prokurimit të kompanisë;
- Të menaxhojë thesarin e kompanisë;
- Të hartojë dhe krijojë buxhetet; dhe
- Çdo detyrë tjetër e caktuar nga Kryeshefi Ekzekutiv;

#### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

#### Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Përgatitje superiore – Fakulteti Ekonomik 4 vjeçar ose me sistem të Bolonjes 3+2.
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në menaxhim të financave dhe/ose kontabilitetit;
- Preferohet të jetë kontabilist i certifikuar nga ndonjë autoritet financiar i licencuar nga KKRF-ja apo ndërkombëtar;
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të të cilave raporton Ndërmarrja;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;

- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime;

#### Aplikacionit për pozitën e ZKF-së duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-në (Biografinë).
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Letër motivimin.
- Diplomën e fakultetit – kopje.
- Dëshmitë e përvojës së punës.
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale.
- Deklaratën nën betim.
- Certifikatën nga gjykata që dëshmon se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

#### Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

Duhet të ketë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike financiare të ndërmarrjes, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të menaxhimit financiar, standardeve të kontabilitetit dhe raportimeve financiare, aftësi të mira të komunikimit, interpretimeve financiare dhe negociimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes financiare dhe ofrimin e opsioneve, njohuri të avancuara në programet e kompjuterit dhe kontabilitetit.

#### Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendrike nga dita e publikimit, deri me datën 02.11.2021 në ora 16:00.

#### Procedura për aplikim:

Aplikacionet e kompletuara sipas këtij konkursi dorëzohen në zarf të mbyllur në Administratën e KRM "Çabrati" Sh.A., rruga "Mazllum Lakuci" p.n. Gjakovë.

#### Paraqitja e kërkesave:

Kërkesat-Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kandidatët me dokumentacion të pa-kompletuar, të pa-plotësuar dhe joadekuat do të refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arbnora Muqaj shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.Mjekësisë "Hysni Zajmi " ne Gjakovë.

► Brezjan Dakaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Nazim Kokollari Budakova " Prizren.

► Jetsin Kosova shpall te pavlefshme 3 dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

**K.R.M. "ÇABRATI"**

Tel. +381(0)390/321 588  
+381(0)390/324 034  
www.cabrati.com  
e-mail. info@cabrati.com  
Gjakovë - Gjakova

Na osnovu člana 21 stav 21.4 Zakona o Javnim Preduzećima br.03 / L-087, kao i izmenama i dopunama Zakona o JP br. 04 / L-111, kao i člana 21, stav 21.3 Statuta preduzeća, Upravni odbor RKO „Çabrati“ DD, na sednici održanoj 28. septembra 2020. godine, odlučio je da 04.10.2021 objavi ovaj:

### KONKURS

**Pozicija:** Glavni Službenik za Finansije i Trezor.  
**Odgovoran je:** Odboru Direktora.  
**Radno Mesto:** RKO „Çabrati“ DD, Đakovica.  
**Plata:** U skladu sa politikom kompenzacije koju je odobrio Odbor Direktora.  
**Vreme trajanja:** Tri (3) godine, sa mogućnošću produženja.

#### Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Glavni Finansijski Službenik će, pod vođstvom glavnog izvršnog direktora, upravljati finansijskim poslovima kompanije, a uzimajući u obzir ograničenja koja je odredio Odbor direktora imaće ovlašćenje da zaključi ugovor za kompaniju u svim finansijske transakcije i biće odgovorni za:
  - Da održava ažurirane i tačne račune preduzeća;
  - Da uspostavi i usmeri sve interne finansijske kontrole, uključujući nabavku, prijem gotovine i stalnih sredstava;
  - Da prati obaveze i racune i koordinira plaćanje faktura i posebnih kupovina;
  - Pre plaćanja pregledati troškove zaposlenih kako bi se osiguralo poštovanje korporativnih politika i budžeta;
  - Vodi i savetuje svo zavisno osoblje radi osiguranja efikasnih rezultata;
  - Pregleda i primenjuje zakone i procedure PAK -a koji regulišu poreska pitanja i obezbeđuje njihovu striktnu primenu;
  - Koordinira, kontaktira i saraduje u obezbeđivanju svih računa i izveštaja u vezi sa PAK -om, i procesima kontrole koje sprovode poreske institucije;
  - Analizira finansijsku klimu i poslovne trendove kako bi pomogao visokim rukovodiocima u kreiranju strateških planova za budućnost;
  - Tumači finansijske informacije kako bi Odboru preduzeća dostavio potrebne izveštaje o izveštavanju;
  - Prati novčane tokove, račune i druge finansijske transakcije;
  - Nadgleda finansijske pomoćnike i drugo osoblje u omogućavanju svakodnevnih operacija, uključujući praćenje finansijskih podataka;
  - Koordinira rad sa Jedinicom za ljudske resurse pri zapošljavanju novog osoblja u finansijskom sektoru;
  - Koordinira rad sa ljudskim resursima na proceni učinka zaposlenih u Sektoru;
  - Pripremiti podatke preduzeća za reviziju na kraju godine;
  - Pregledati, organizovati nabavku i održavanje svih bezbednosnih politika vezanih za poslovanje;
  - Koordinirati druge poslovne funkcije, kao što su iznajmljivanje zgrada i opreme, kao i kupovina sa izvršnim direktorom i službenikom za nabavku kompanije;
  - Upravljati trezorom preduzeća;
  - Da dizajnira i kreira budet; i
  - Sve druge dužnosti koje dodeljuje glavni izvršni direktor;

#### Potrebni uslovi i kvalifikacije:

Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe priznatog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, kao i kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2 tačke (d), (f), (j), (k) i (l) Zakona o javnim preduzećima i imaju potrebno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za dotično radno mesto.

#### Pored opštih uslova, kandidati moraju ispunjavati i sledeće posebne uslove:

- Vrhunska obuka - četvorogodišnji Ekonomski fakultet ili sa Bolonjskim sistemom 3 + 2.
- Da imaju najmanje 5 godina radnog iskustva u finansijskom upravljanju i / ili računovodstvu;
- Po mogućnosti treba da je računovođa koji je ovlašćen od finansijskog autoriteta sa licencom KKFR -a ili na međunarodnom nivou;
- Poznavanje tumačenja Međunarodnih računovodstvenih standarda (IAS) i Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI) prema kojima preduzeće izveštava;
- Imati visok moralni i profesionalni integritet;
- Poznavanje stranih jezika je prednost;
- Da nije osuđivan ili pod istragom;

Uz prijavu za radno mesto za Glavnog finansijskog službenika moraju se priložiti sledeći dokumenti:

- CV (Biografija).
- Kopija lične karte.
- Motivaciono pismo.
- Fakultetska diploma - kopija.
- Dokazi o radnom iskustvu.
- Dokazi o stručnom usavršavanju.
- Izjava pod zakletvom.
- Potvrda suda koja dokazuje da niste pod istragom, ne starija od šest (6) meseci.

#### Potrebne veštine, iskustvo i drugi atributi: Aftësitë,

Mora imati vještine u definisanju i postizanju strateških i finansijskih ciljeva preduzeća, visoke organizacione i menađerske veštine, odlične veštine finansijskog upravljanja, računovodstvene i standarde finansijskog izveštavanja, dobre komunikacijske vještine, finansijska tumačenja i pregovaranje, provjerene vještine za analizu finansijskog stanja i pružanje mogućnosti, napredno znanje u računarskim i računovodstvenim programima.

#### Datum zatvaranja konkursa:

Konkurs je otvoren 30 kalendarskih dana od dana objavljivanja, do 02.11.2021 u 16:00.

#### Procedure za prijavu:

Popunjene prijave prema ovom konkursu podnose se u zatvorenoj kovrti Upravi RKV "Çabrati" dd, ulica "Mazllum Lakuci" bb Đakovica.

#### Podnošenje Zahteva:

Zahtevi-prijave podnete nakon isteka roka neće biti prihvaćeni. Kandidati sa nepotpunom, neispunjenom i neadekvatnom dokumentacijom biće odbijeni.

Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor. Kandidati koji budu izabrani i pozvani na intervju moraju doneti originalne dokumente na uvid.

